

REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT AGENCIA PROTIV KORUPCIE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. <u>DPK/DMP</u>	Nr Prot. Br. Prot. Prot No. <u>03-1310/2012</u>
Nr. I llog. Bregj. Graçanica Nr. pages <u>02</u>	Data Datum Date <u>11.04.2012</u>
PRISHTINE	

GJL. nr.245/2012

GJYKATA E LARTË PËR KUNDËRVJATJE NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë prej gjyqtarëve: Ragip Namani kryetar, Dalip Bega dhe Ramiz Kuqi anëtarë, me pjesëmarrjen e sek. juridike Ganimete Dumani, duke vendosur lidhur me ankesën e paraqitur nga i pandehuri Bogoljub Staletovic nga Graçanica, kundër aktvendimit të Gjykatës Komunale për Kundërvajtje në Prishtinë, Regj.I.nr.24899/2011, të dt. 12.12.2011, e në bazë të neneve 31 al. 3, 39 dhe 221 të Ligjit për kundërvajtjet, m e datë 28.02.2012, nxjerr

A K T V E N D I M

Ankesa e paraqitur është e bazuar.

NDRYSHOHET aktvendimi i Gjykatës Komunale për Kundërvajtje në Prishtinë, Regj.I.nr.24899/2011, i dt. 12.12.2011, ashtu që ndaj të pandehurit Bogoljub Staletovic, nga Graçanica PEZULLOHET procedura kundërvajtëse, konform nenit 198 al. 1 pika 8 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, në mungesë të provave.

Nga një kopje të këtij aktvendimi duhet dorëzuar palëve

A r s y e t i m

Gjykata Komunale për Kundërvajtje në Prishtinë, me aktvendimin Regj.I.nr.24899/2011. të dt. 12.12.2011, të pandehurin Bogoljub Staletovic, nga Graçanica, e ka shpallur përgjegjës: sepse si Zyrtar i Lartë Publik, në pozitë të Zëvendësit të Kryeshefit të Sekretariatit të Këshillit Qendror Zgjedhor, nuk ka bërë deklarimin e rregullt vjetor të gjendjes së pasurisë në Agjencinë Kundër Korrupsion deri me 31.03.2011, me ç, veprim ka bërë kundërvajtje nga neni 6 para. 2 e ndëshkuar me nenin 16 para. 1 pika 1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik, për të cilën kundërvajtje i është shqiptuar gjopa në shumë prej 400€. Me të njëjtin aktvendim i pandehuri obligohet që në emër të paushallit gjygjësor të paguajë shumën prej 5 €.

Kundër këtij aktvendimi i pandehuri Bogoljub Staletovic ka paraqitur ankesë, në të cilën në mes tjerash cek: se deklarimin e pasurisë për vitin 2010 ka shkuar përmes Xh. Peqanit, i cili është dashur sipas marrëveshjes me nëpunësen e cila ka qenë e ngarkuar për këtë çështje që t, ua shpërndajë të gjithë zyrtarëve të lartë njoftimin, se fatkeqësisht kjo nuk ka ndodhur, se nëpunësja V. Kida, në asnjë moment nuk e ka parë të arsyeshme që as zyrtarisht as në mënyrë elektronike e as privatisht ta lajmëroi për deklarimin e gjendjes pasurore, se me iniciativë personale pas një kohe të gjatë pas 5 muaj ka dashur të verifikoi se a është dashur që edhe ky të paraqesë deklarimin e pasurisë dhe gjatë bisedës me nëpunësen ajo i ka thënë që edhe këtë e ka lajmëruar në mënyrë elektronike, se ky këtë e ka demantuar e njëjta ia ka treguar posten elektronike ku është vërejtur se imailin e tij e njëjta e ka shkruar gabim dhe se një kohë të gjatë nuk e ka vërejtur se posta i është kthyer se deklarimin e pasurisë e ka bërë me vetiniciativë me datën 02.08.2011, me arsyetim pse është vonuar. Se në gjykatë e ka sqaruar që nuk ka qenë qëllimi i tij të i shmanget ligjit por për arsye procedurale dhe dështimit-mos azhuritetit të nëpunëses që ta lajmëroi me kohë se nëpunësja nga tri herë që ka komunikuar me imail asnjëherë nuk e ka shkruar adresën e saktë të tij të cilën mund të dëshmoi, se me përgjegjësi deklaroi se lëshimi kryesor për mos

03-1310/2012/02
feriz

2.

deklarim të pasurisë ka qenë lajmërimi i dobët nga ana e nëpunëses, sepse ky me rastin e marrjes së detyrës së re Zëvendës, Avokat i popullit e ka deklaruar pasurinë në afat, dhe nga të lartcekurat shpreson që Gjykata e Lartë për Kundërvajtje, do ti ketë parasysh faktet e cekura dhe të anuloi dënimin. Ankesës ia bashkangjetë listën e AKK, vërtetimin e dorëzimit të fletëparaqitjes të datës 02.08.2011, dhe 08.11.2011, dhe dy dëshmi për gabimet në imail (fotokopje).

Kolegji vlerësoi thëniet në ankesën e paraqitur, aktvendimin e goditur, deklaratën e të pandehurit e të dhënë në procesverbal gjatë marrjes në pyetje në gjykatë të shkallës së parë më datë 11.11.2011 i cili nuk e pranon kryerjen e kundërvajtjes deklaratën e dëshmitares nëpunëse e KQZ-së Valbona Kida si dhe shkresat tjera nga lënda dhe konstatoi se ankesa e paraqitur është e bazuar, kurse aktvendimin e goditur e ndryshoi ashtu që ndaj të pandehurit Bogoljub Staletovic, konform nenit 198 al.1 pika 8 të Ligjit për Kundërvajtjet, e PEZULLOI procedurën kundërvajtjese në mungesë të provave.

Kolegji mori këtë vendim duke u bazuar në deklaratat e të pandehurit Bogoljub Staletovic dhe dëshmitares V. Kida, të dhënë në gjykatën e shkallës së parë ku i pandehuri nuk e pranon kryerjen e kundërvajtjes dhe thekson se zyrtarja V. Kida si zyrtare kontaktuese në mes të KQZ dhe AKK njoftimin për deklarim të pasurisë ia ka dërguar në imail të shkruar gabimisht dhe gjatë shikimit me të njëjten zyrtare së bashku e kanë vërejtur këtë gabim dhe për këtë arsye nuk ka qenë i njoftuar me kohë, ndërsa dëshmitarja në deklaratën e saj të dhënë në gjykatën e shkallës së parë ndër të tjera ka theksuar se të pandehurit ia ka dërguar njoftimin për deklarim të pasurisë me imail, mirëpo thekson se për këtë zyrtar ka qenë një pështjellim lidhur me imail adresën e tij, mandej deklaroi se nuk i kujtohet se a i është kthyer konstatimi përmes imailit si adresë e gabuar, mandej thekson po ashtu se ka mundur ti ketë shkruar dikujt me atë adresë dhe se pasi ka kaluar afati për deklarim të pasurisë i pandehuri i ka thënë kësaj se nuk e ka marrë njoftimin përmes imailit, e po ashtu deklaroi se nuk i kujtohet se i pandehuri i ka dërguar imail adresën korrekte të tij. Nga këto dy deklaratat dhe dëshmi tjera me shkrim e sidomos komunikimeve në mes të pandehurit dhe dëshmitares V. Kida, përmes imailve(ku në lëndë gjendet fotokopjet), vërehen gabime në imail adresën e të pandehurit, andaj nga këto fakte konstatohet se i pandehuri nuk është njoftuar në mënyrë të rregullt dhe ligjore për deklarimin e rregullt të pasurisë vjetore në AKK nga zyrtari kontaktues në mes të KQZ dhe AKK-së ashtu siç parashihet me nenin 3 pika 1.5 të Ligjit për Deklarimin Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik (Ligji 03/L-151) dhe Kolegji në mungesë të provave, aktvendimin e goditur e ndryshoi ashtu që ndaj të pandehurit Bogoljub Staletovic PEZULLOI procedurën kundërvajtjese në mungesë të provave.

Nga të lartcekurat e në vështrim të nenit 221 të Ligjit për kundërvajtjet u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

GJYKATA E LARTË PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË

GJL. nr.245/2012, të dt. 28.02.2012.

SEK. JURIDIKE,
Ganimete Dumani

KRYETARI I KOLEGJIT

Ragip Namani